



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**LEGJISLATURA VIII**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Mbledhja nr.78

Prishtinë, më 10.05.2024, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Bekë Berisha, kryetar i Komisionit Enver Dugolli- nënkryetar i parë, Erxhan Galushi - nënkryetar i dytë, Shqipe Mehmeti Selimi, Mefail Bajqinovci, Arbër Rexhaj, Anton Quni, Dimal Basha. Hisen Berisha, anëtar.

**Mungoi:** Rashit Qalaj-anëtar.

**Përfaqësuesit e Policisë së Kosovës:** Gazmend Hoxha-Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Fehmi Hoti-Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm, Agron Nezaj-Drejtor i Departamentit të Hetimeve, Muhamet Berisha-Kabineti i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Faton Krasniqi- ndërlidhës legjislativ mes Kuvendit dhe Ministrisë së Mbrojtjes, Besnik Fetahu (Grupi parlamentar i VV), Laurenta Zogaj-Asistente në Komisionin Parlamentar

**Nga stafi mbështetës i komisionit:** Nur Çeku (koordinator), Zarë Aliu (zyrtare e lartë)

**Mbledhjen e kryesoi Bekë Berisha,** kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

Raportimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës Kol.Gazmend Hoxha.

**Kryetari**, i nderuar Drejtor i përgjithshëm i Policisë, z.Hoxha, i nderuari z.Hoti dhe Neza, ashtu siç ju kemi njoftuar përmes e-mailit, për të raportuar për ndryshimet e bëra në njësinë e hetimeve në kuadër të Policisë së Kosovës, ku për këtë çështje ka pasur raportime edhe në media. Task forca antikorrupsion e Policisë së Kosovës ishte themeluar në vitin 2010 dhe ka funksionuar deri në vitin 20120, ku oshte shuar nga Kryeministri Hoti, ku pas shuarjes së kësaj njësie, Vetëvendosja kishte thirrur seancë të jashtëzakonshme, ku kishin bërë kritikë që kur të vijnë në pushte, do të fuqizojnë njësinë e hetimeve. Por ajo çfarë ndodhi, me ardhjen në pushtet të VV u emërua Drejtori i ri i Policisë së Kosovës, pushteti e shkarkoi nga pushteti nga njësia e veçantë e hetimeve, udhëheqësin e kësaj njësie Shemsi Haziri, pikërisht në kohën kur po hetohej afëra e Martin Berishës, Nagip Krasniqit, Ministria e Tregtisë dhe industrisë, Ministri Elbert Krasniqi, Shkarkimi i Shemsi Hazirit, kishte ardhur pasi ai kishte pasur një takim me ministrin e Brendshëm z.Xhela Sveçla në Blinaj të Lipjanit. Takimi kishte zgjatuar për orë të tëra dhe ministri i kishte kërkuar llogari pse janë ngutur për dorëzimin e kallximit penal për Martin Berishën. Për këtë ekzistojnë edhe incizime edhe raportime. Betimi për drejtësi e ka një hulumtim për këtë çështje, ndërsa shkarkimi i Shemsi Hazirit ishte identifikuar edhe në raportin e Departamentit të Shtetit dhe Freedom House. Me shkarkimin e Shemsi Hazirit, në krye të Njësisë së veçantë të hetimeve erdhi Besim Berisha, ku disa vite më parë ishte larguar nga kjo njësi. Besim Berisha vije nga fshati Konushefc, fshat komshi me fshatin Svecël prej nga vjen Ministri i Brendshëm. Me ardhjen në këtë pozitë të komshiut të Sveclës, në këtë njësi fillon njëfarë presioni, si pasoj e presionit katër hetues u larguan nga njësia që e lufton korrupsionin. Format e presionit janë të llojit, ku hetuesit detyrohen të dorëzojnë raportet me shkrim, për çdo takim që kanë me prokurorët e rasteve që i trajtojnë. Kjo është e ndaluara pasi hetimi është konfidencial, ndërsa në trajnime dërgohen zyrtar që kanë raporte të afërta me shefin e ri. Ndërsa s ai përket notimit vjetor të performancës për hetuesit që merren me hetimin e rasteve korruptive në Qeverinë Kurti ka qenë i ulët dhe kjo ndikon në ngritjen në karrierë duke krijuar situata për largimin e tyre nga njësia. Në emër të një strukturimi të njësisë, ka filluar një fushatë ndaj hetueseve që po hetojnë raste e korrupsionit në Qeverinë Kurti, më poshtë gjen emrat e hetuesve dhe listën e propozuar për largimin nga njësia. Sipas raportimeve në media, ata tashmë janë larguar edhe nga sistemi elektronik, ku janë pjesëtarët e njësisë së veçantë. Ekipi hetuese me numër 6, që ka qenë duke i hetuar, aferat si ajo e rezervave shtetërore, rasti i Faruk Mujkës për pjesën e KEK-ut, është shuar si ekip. Hetuesit e kësaj ekipe, janë shpërndarë nëpër ekipe të tjera, si rreshteri Idriz Gashi është propozuar për largimin nga njësia e veçantë hetimore e Policisë së Kosovës. Hetuesi rreshter, Ekrem Ibishi, i cili ka hetuar rastin e Ambasadorit Martin Berisha është në listën e largimin nga kjo njësi. Hetuesja rreshtere, Anita Avdyli, e cila është duke e hetuar një kontratë lidhur me Ministrinë e Jashtme dhe të Diasporës, është në listën përfundimtare për largimin nga njësia e hetimit të veçantë. Ndërsa hetuesi Habib Tërdevci, i cili është duke e hetuar Ministrinë e Tregtisë, për dhënien në shfrytëzim të një tokë për Kosmonte food për njëqind vjet, është në listën e largimit përfundimtar nga njësia e veçantë. Toger Zeqir Kajtazi, ka qenë duke e hetuar Zëvendës Ministrin Hysen Durmishi, për rrugën Prishtinë-Podujevë është në listën e largimit përfundimtar dhe është degraduar. Nga shtatë hetues që janë për largim nga njësia, pesë prej tyre kanë qenë duke i hetuar aferat më të njohura korruptive, që janë përfshirë zyrtarët e shtetit. Ka pasur tendencë që këta hetues të largohen, por me kërkesë të prokurorëve special nuk është lejuar largimi i tyre. Personat që janë në listën e largimit janë persona nga Drenasi, Mitrovica dhe Vushtrria, pra pre supozohet pjesa që kanë lidhje me opozitën. Ka pasur ndryshime në pozitat udhëheqëse dhe kryesisht janë emëruar persona të afërt me shefin Besim Berisha dhe kryesisht me prejardhje nga Podujeva, zinxhiri është

ndryshuar nga Besim Berisha, sipas dyshimeve në ndikimin e ministrit të Brendshëm, i cili i kërkon llogari shefit Shemsi Hazirit për hetime, shefat e ri nga Podujeva dhe lidhet me njeriu e Sveçlës. Shefi i Njesisë së veçantë nga Podujeva, fshat fqinjë me ministrin Sveçla, më herët kishte qenë i larguar nga po kjo njësi, tash çuditërisht është parë e arsyeshme kthimi i tij në këtë njësi dhe të bëhet udhëheqës i kësaj njësie. Pra të gjitha ato që janë raportuar në media, i kam të argumentuara dhe me fakte. Ndërsa zëvendësi i njesisë së veçantë, Blerim Selmani nga Podujeva, dyshime për afërsi me shefin Besim Berisha, shefi i ekipit është bërë toger Agron Abdullahu nga Podujeva, dyshime për afërsi me shefin Besim Berisha, të cilin e emëroi Sveçla. Shefi i ekipit është bërë rreshter Fitim Kastrati nga Podujeva, Avni Reqica po ashtu shef i ekipit edhe ky nga Podujeva, Vehbi Zabërxha është bërë shef i ekipit dhe ka lidhje me majorin Besim Berisha. Po ashri shef ekipi është bërë Ridvan Obërtinca, shok i ngushtë i majorit Besim Berisha. Shef ekipi është bërë Mehdi Krasniqi, i cili ishte larguar nga njësia e veçantë hetimore dhe është kthyer nga ndikimet brenda policisë, dyshime se ka qenë duke u hetuar për pastrim të parave. Pra komplet këta shefa që janë emëruar në këto pozita, përzgjedhin se cilët hetues do ti hetojnë aferat korruptive. Tash e tutje aferat korruptive nuk mund të hetohen nga hetuesit që etiketohen si të opozitës brenda njesisë së veçantë hetimore. Diskriminimi bëhet edhe në dërgimin në trajnime të hetuesve, shfrytëzimin e veturave. Në vitin 2023 në muajin korrik, major Shemsi Haziri, është ftuar nga Drejtori i Përgjithshëm Gazmend Hoxha dhe i është komunikuar vendimi verbal për transfer, pa asnjë arsytim dhe është kuptuar që është vendim nga niveli politik. Reagimi i majorit Shemsi Haziri, kishet qenë se kjo është për shkak të hetimeve të fundit të Martin Berishës, Nagip Krasniqit për rezervat shtetërore, Ministres Donika Gërvalla, Zëvendës Ministres Liza Gashi dhe ministrit Hajrullah Ceku. Është duke u hetuar Ministri Elbert Rrahmani për fondin për komunitete dhe keqpërdorim rreth dyqind mijë euro, Hysen Durmishi për tiketa ngjitëse dhe mirëmbajtjen e autostradës dhe rrugën e Podujevës. Majori Shemsi Haziri, kishte qenë tre herë në takime, dy herë në Malin e Zi dhe një herë në Slloveni për rastin e Martin Berishës dhe pas kthimit të majorit nga Mali i Zi herën e fundit ka ndodhur transferimi, pasi ka qenë pikë e vetme kontakti me hetuesin në Mal të Zi. Ndërsa nga Drejtori i është thënë që ai duhet të hiqet nga njësia. Me qëllim të sistemimit të tij, është krijuar një pozitë për të, gjatë punës në polic z.Haziri ka pasur pesë medalje, pesëmbëdhjetë mirënjohje dhe në vitin 2008 është shpallur polic i vitit, vlerësimin e performancës asnjëherë nuk e ka pasur nën 5, ndërsa shkollimi i tij është që ka përfunduar fakultetin juridik dhe të kriminalistikës, ka mbi tridhjetë trajnime jashtë shtetit për krim të organizuar dhe korrupsion. Në strukturën e brendshme të njesisë së veçantë të hetimeve kanë qenë gjashtë ekipe, ekipi numër gjashtë është shuar komplet nga shefi i ri, ndërsa shefin e ekipit të gjashtë nga Rezalla, Idriz Gashi e ka futur në listë për ta larguar dhe e ka vlerësuar me notën 2.5, pasi ky ka qenë duke u hetuar Ministren Rozeta Hajdari dhe Nagip krasniqi për rezerva shtetërore. Ekipi numër tre, ku shef ka qenë togeri Zeqir Kajtazi nga Skenderaj, në vend të tij është caktuar një shef tjetër me gradën rreshter, ndërsa z.Kajtazi është në listë për tu larguar. Z.Zeqir Kajtazi ka qenë duke u marrë me rastin për hetimin e autostradës, ku i përfshirë është Hisen Durmishi. Ekipi numër katër, shef i këtij ekipi ka qenë Naser Bajra nga Mitrovica, ku nga presionet direkt dhe indirekte ka qenë i detyruar të largohet nga njësia e veçantë e hetimeve, për rastin e hetimit të tiketave ku i përfshirë ka qenë z.Hisen Durmishi, gjithashtu në ekipin e tij është rreshteri Habib Tërdevc i nga fshati Gilobar i Drenasit i cili ka qenë duke u hetuar rastin e *Kosmonte food*, pjesë e rastiit të rezervave shtetërore, ku të dyshuar janë pjesëtar të Ministrisë së Tregtisë dhe industrisë. Gjithashtu në listë për tu larguar është edhe rreshteri Ekrem Ibishi nga fshatit Druar i Vushtrrisë, i cili është pjesë e ekipit prej katër hetuesve që janë vendosur në PSRK me kërkesën e

kryeprokurorit që e kanë rastin e Martin Berishës, Nagip Krasniqir, rezervave shtetërore. Gjithashtu në listë për tu larguar është edhe rreshterja Anita Avdyli, e cila ishte duke e hetuar rastin e Ministrisë së Jashtme, ku e dyshuar është Ministra e Jashtme Donika Gërvalli dhe zëvendësja e saj, Liza Gashi për rastin e Karitasit zviceran, ku nga burgjet, buxheti i shtetit i janë paguar 344.000 euro. Të larguar nga kjo njësi, nga presioni janë, toger Naser Bajra, rreshter Blerim Gashi, rreshter Ekrem Ferati, Fadil Gashi. Edhe struktura e re nga ata që i përmenda, që janë të gjithë nga Podujeva, këto janë dyshimet i nderuar Drejtor, tutje bisedën e bëjmë interaktive.

**Enver Dugolli**, i nderuar Kryetar, ju shfrytëzuar pozicionin që keni, me gjithë respektin, por assesi nuk është në rregull të keqpërdoret ky pozicion, dhe Komisioni të humb rolin që ka. A jemi në gjykatë? Më vjen keq, pasi është hera e parë që thirret një institucion dhe i bëhen akuza direkte, të cilat nuk e di nëse edhe Prokurori do të ishte në gjendje të bënte duke u thirrur në emra dhe mbiemra. Kam mirëpritur që e keni ftuar Drejtorin, por ka pasur anëtar të Komisionit që janë prononcuar dhe kanë përmendur emra dhe në pamundësi të shfrytëzojnë të drejtën që të padisin. Tutje tha që iu bënë thirrje, që të gjithë ata deputet që iu kanë përmendur emrat e zyrtarëve policor, ti padisin. Nuk është në rregull që të luajmë rol dhe ti tregojmë Drejtorit se si vlerësohen policët. Pat akuza që vlerësohen dobët, vlerësohen me nota të larta. Nuk është në rregull ti tregojmë Drejtorit që ju bëni organo gram për të sistemuar njerëz. Me këtë qasje nuk jemi duke i ndihmuar as policisë dhe as atyre që ju i përmendët.

**Kryetari**, ne jemi mekanizëm mbikëqyrës ndaj policisë, këto që u thanë nuk janë akuza, por janë çështje që janë ngritur nga mediat. Pastaj është bërë hulumtim, e kemi Betimin për Drejtësi, ku janë sqaruar shumë gjëra të tjera dhe këtu nuk i fola ato që janë më të rëndësishme. Çështjet që i ngrita nuk janë sekret, janë çështje që janë diskutuar, është fakt që dominojnë nga rajoni i Podujevës.

**Shqipe Mehmeti Selimi**, i nderuar Kryetar, na ke ftuar në mbledhje për raportimin e Drejtorit të Policisë, në e-mail nuk kemi pranuar me shkrim që do të raportonte për këtë çështje. Ndërsa ju keni gjysmë ore që mbani referat, duke akuzuar Drejtorin e Policisë, Policinë dhe ndërhyrjen në puën e policisë. Ju kisha sugjeruar që të bëni një konferencë për shtyp dhe ti thojë të gjitha shqetësimet e juaja dhe jo të keqpërdorni me emra dhe mbiemra policinë në këtë mbledhje. Nëse mbledhja vazhdon në këtë mënyrë, do të dështoj, pasi nëse do të ishte lajmëruar që për këtë çështje, do duhej të kishim takimin me dyer të mbyllura.

**Kryetari**, ftesën e dinë Drejtori si e kam dërguar, kjo temë është hapur në seancë. Dhe çështjet e ngritura ishin ato që janë folur në media.

**Anton Quni**, theksoi se kur është nisur për këtë takim, ka menduar që do të flitet për performancën e policisë, për sfidat etj., por çështjet e ngritura e ndryshuan natyrën e takimit tonë. Është fakt që të gjitha çfarë ë u thanë janë në media, tutje theksoi se pajtohet me çështjet që u ngritën dhe është shumë i interesuar që të dëgjoj nga Drejtori, se do ti adresoj të gjitha këto çështje. Po ashtu nuk mund ti tejkalojmë dhe të heshtim këtë temë, pasi nuk është vetëm problem i policisë por është i shtetit, pas këtij takimi Prokuroria do të duhej të merret me çështjet e ngritura.

**Kryetari**, sa i përket asaj se si është dërguar njoftimi, iu referua e-mailit të dërguar, ku është thënë që raportimi i drejtorit të Policisë do të jetë për ndryshimet e bëra në njësinë e hetimeve, pra është shkruar qartë.

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë s Kosovës, Gazmend Hoxha**, fillimisht prezantoi ekipin e tij, duke shtuar se na pozita e Drejtorit, njofton zyrtarisht se nga Njësia e Veçantë e Hetimeve nuk ka pasur largime apo transferime të asnjë polici jashtë njësisë, përveç major Shemsi Hazirit, i cili është transferuar në kuadër të reformave që si drejtor ka zbatuar, me qëllim të rritjes së vizionit dhe objektivave si Drejtor i ri i policisë, po ashtu edhe në zbatim të strukturës së re organizative me qëllim për të arritur efikasitetin e punës në polici, në veçanti në fushën e hetimeve. Ju përmendet emrat që kanë lëvizur nga kjo njësi, ju garantoj me gjithë autoritetin tim, që këto katër lëvizje, janë bërë me kërkesën e tyre, pra asnjë polici nuk është larguar, pa kërkesë dhe pa vullnetin e tyre.

**Kryetari**, a kanë pasur presion Drejtor?

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë s Kosovës, Gazmend Hoxha**, jo, nuk kanë pasur presion. Shumica e kërkesave kanë qenë për nevojat e tyre personale. Duhet pasur parasysh, që më herët kjo njësi e ka pasur një shtesë ekstra 300 euro, e cila është ndaluar në momentin e shuarjes së task-forcës, ndoshta mund të jetë edhe stimulimi që ka ndikuar. Mund ti kontaktoj disa polic, këta që kanë kërkuar personalisht që të transferohen dhe nuk ka listë të largimit të tyre. Ekziston një problem, sepse struktura e kësaj njësie në të kaluarën ka pasur tridhjetë polic, ndërsa me strukturën e re është paraparë që kjo njësi ti ketë 27 zyrtar policor. Brenda njësie janë bërë disa reforma, me qëllim të përcaktimit të detyrave dhe përgjegjësisive të eprorëve. Disa gradë janë rritur në pozicione, disa janë zvogëluar. Ndërsa sa i përket asaj se dikush vjen nga Drenica, dikush nga Podujeva, theksoi se personalisht vjen nga Drenasi dhe nuk e ka informacionin se sa janë nga ky rajon. Sa i përket Shemsi Hazirit, thekso se e ka transferuar në kuadër të reformave të mëdha që janë bërë në departamentin e hetimeve. Në kuadër të këtyre reformave është ndërruar Drejtori i Hetimeve, po ashtu shefi i hetimeve për krime të rënda, shefi i forenzikës, shefi i hetimit për trafikim me qenie njerëzore, drejtori i hetimeve të rënda dhe është emëruar Drejtori i ri i divizionit të hetimeve dhe kjo në zbatim të reformave. Ashtu siç e thatë edhe ju, Shemsiu mbetet një epror i vyeshëm i policisë dhe tani është në pozitë të zëvendës Drejtorit në drejtorinë kundër narkotikëve, ku kjo fushë është e një rëndësie të veçantë dhe si menaxhment e kemi prioritet të punojmë shumë. Pozita e zëvendës drejtorit është me strukturën e re.

**Kryetari**, i nderuar Drejtor, për ta autorizuar një drejtor që të shkoj jashtë, kush e autorizon?

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë s Kosovës, Gazmend Hoxha**, çdo udhëtim jashtë Kosovës, me qëllim trajnimit apo takimeve zyrtare, bëhet me kërkesën e aprovuar nga eprori i drejtpërdrejtë dhe më pas kërkesa tek Drejtori i Policisë.

**Kryetari**, prej që është larguar Shemsi Haziri, që ka qenë duke e hetuar rastin Berisha për të cilën gjë ka fakte, a ka vazhduar dikush nga kjo njësi të merret me këtë punë? A kanë kërkuar leje për kryerjen e ndonjë hetimi jashtë?

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë s Kosovës, Gazmend Hoxha**, sa i përket asaj që a ka pasur udhëtime jashtë dhe arsyen, thekso se arsyetimet jepen tek eprori i parë ndërsa tek Drejtori vjen vetëm si kërkesë. Asnjëri nga policët që kanë punuar në këtë njësi dhe vazhdojnë të punojnë, nuk është dëmtuar nuk është intimiduar, kërcënuar apo shantazhuar. Nuk ka listë të largimit të njerëzve, por janë disa pozicione të cilat duhet parë se si të sistemohen. Tani janë dy zyrtar, grada e të cilëve nuk përkon me pozitën që janë në këtë departament, mirpo nuk ka favorizime lokaliste dhe të tjera. Avancimi do të bëhet vetëm sipas performancës, nuk ka ndikime të natyrës që u përmend dhe nuk do të lejojmë ndikim politik në këtë njësi dhe të tjerat.

**Kryetari**, a keni presion politik?

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë s Kosovës, Gazmend Hoxha**, jo, nuk kam presion politik.

**Kryetar**, a janë bërë këto ndryshime, në mënyrë që të mbrohen këta ministra të korruptuar, dihen që janë të korruptuar, disa janë në bord dhe hajnia që u bë me rrymë?

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë s Kosovës, Gazmend Hoxha**, asnjë ndryshim apo lëvizje, nuk bëhet me qëllim të mbrojtjes apo ndjekjes së dikujt. Çdo ndryshim që bëhet, bëhet sipas vlerësimit të performancës dhe nuk merrem me emra se kush hetohet. Jemi për krijimin e kushteve të punës dhe e mbështesim. Udhëheqës, mbikëqyrës, drejtues i hetimeve, nuk është policia, është Prokurori.

Kryetari, më sipër e theksova që sipas Besim Berishës, duhet që policët hetues të bashkëpunojnë me prokurorin që të raportojnë se cilat raste po hetohen nga Prokuroria. A është e vërtetë?

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha**, major Besim Berisha është shefi i kësaj njësie, normalisht që duhet të ketë informacione se kush po hetohet dhe të jap udhëzime, të mbështet policët hetues.

**Shqipe Mehmeti Selimi**, duke iu referuar formës së raportimit, thekso se kjo më shumë i ngjan një interviste të prokurorit sesa në mbledhje të Komisionit dhe pyetjes që bëjmë si deute. I nderuar Kryetar, nëse dëshiron që të vazhdon mbledhja, fokusohu në pyetjet në mënyrë që të jap Drejtori përgjigjeje, pasi mbledhja është për të gjithë anëtarët e Komisionit.

**Agron Neza, Drejtor i Departamentit të Hetimeve**, unë do të ndalem pak tek statistikat, për shkak të volumit dhe nevojës për ndryshim që ka qenë në strukturë, kur ne kemi ardhur në pozicion, pasi kemi paraparë që të kemi një ndryshim në strukturën organizative që ti përshtatemi funksionit të kësaj njësie dhe të rriten kapacitete në këtë njësi. Disa statistika po i referohem vitit 2022 dhe 2023 për shkak të ndryshimit të eprorëve që janë bërë në njësi, ku në citin 2022 raste të reja kanë qenë dy raste, 2023 pesë raste të reja, nga janari 2024 tetë raste të reja. Raste që janë mbyllur dhe të përfunduara në 2022, nuk ka qenë asnjë rast. Në vitin 2023 kanë qenë pesë raste të mbyllura, informata të bartura në 2023, 79 informata, 8 janë tani, shkresa dhe informata të reja 69 në vitin 2023, në vitin 2022 nuk ka pasur informata të mbyllura, në vitin 2023, 32 informata, ndërsa nga janari 2024, 25 informata. Operacione policore në vitin 2022 nuk ka pasur, kurse në vitin 2023, 3

operacione policore, ku 90 persona janë arrestuar, në vitin 2022 1 person i arrestuar, në vitin 2023, 3 persona të arrestuar, në vitin 2022 kanë qenë katër aktakuza, në vitin 2023, katër aktakuza, tani e kemi një aktakuzë të ngritur. Kallxime penale në vitin 2022, shtatë, në vitin 2023, pesë, ndërsa tre aktakuza nga janari i këtij viti. Para të sekuestruara në vitin 2022, janë një milion e nëntëqind mijë euro, kurs enë vitin 2023, katër milion e tridhjetë mijë euro. Sa i përket hetimeve, të gjitha që kanë qenë duke u zhvilluar, vazhdojnë të hetohen, sa i përket ndryshimeve, posedoj edhe emrat, por nuk e di sa është etike që ti përmend, mirë asnjë zyrtar policor, përveç shefit nuk është larguar nga njësia, përveç katër zyrtarëve të cilët kanë bërë kërkesë me shkrim. Nuk kemi pasur informacione që kanë pasur presione, të gjitha rastet janë nën direktivat e prokurorisë speciale dhe vazhdojnë të jenë.

**Kryetari**, në këtë pikë dua të ndalem z.Neza. Pra një polic hetues para se të njoftoj prokurorin për një njoftim, duhet të njoftoj shefin e ekipit, zëvendës shefin e ekipit të njësisë dhe shefin e njësisë. A është e vërtetë kjo? Këta pesë zyrtar që janë në listë, a figurojnë në sistemin elektronik të policisë në kuadër të njësisë?

**Agron Neza, Drejtor i Departamentit të Hetimeve**, theksoi se e kanë një problem teknik të sistemit Prims, gjithë policia, pra është problem teknik, i cili këto ditë pritet të rregullohet. Me strukturë të re duhet ti kem vetëm 5 persona drejtpërdrejtë, por ndodh që 20-30 kalojnë për shkak të problemeve teknike tek kjo njësi.

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë s Kosovës, Gazmend Hoxha**, i nderuar Kryetar, asnjë zyrtar nuk është në listë të largimit, sistemi Prims ka të bëjë me të dhënat e tyre, trajnimet, përvojën etj. Ndërsa s ai përket pyetjes së parë, a duhet ti jap llogari polici hetues, rreshterit të tijë, përgjigjësja është po. Pasi nuk und të shkëputet zinxhiri komandues.

**Kryetari**, i nderuar Drejto ende nuk je përgjigjur për rastin në Blinaj, dymbëdhjetë orë, Shemi Hazirit iu ka bërë presion nga Ministri Sveçla, pse ke ngritur kallxim penal kaq shpejt. A ke informacion për këtë dhe a është e vërtetë?

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë s Kosovës, Gazmend Hoxha**, theksoi se nuk ka informacion, ndërsa ky takim, ka qenë në kuadër të punëtorisë për policinë ku është punuar në një strategji për planifikimet e ardhshme të policisë.

**Mefail Bajqinovci**, i nderuar Drejtor, kur e keni bërë reformën, u përmend emri i Shemi Hazirit. Ju e dini që unë i njoh të gjithë dhe publikisht e kam mbrojtur task-forcën kur LDK-ja ka dashur ta shuan. Sa i përket reformës së juaj, pyetja është konkrete. A ka pasur shkelje Shemi Haziri gjatë punës së tij? A ka pasur shkelje gjatë Covid-it?

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë s Kosovës, Gazmend Hoxha**, sa i përket pyetjes së parashtruar nga z.Bajqinovci, theksoi se nuk e dinë pasi nuk e ka pasur nën mbikëqyrje dhe në atë kohë nuk ka qenë Drejtor.

**Fehmi Hoti**, theksoi se në atë kohë ka qenë Zëvendës Drejtor, me sa di është trajtuar nga Standardet Profesionale, por nuk ka informacione se si ka përfunduar. Të paktën me që nuk ka lëvizur, ka përfunduar pastër. Është trajtuar prej hetimeve të brendshme.

**Mefail Bajqinovci**, kur e keni bërë reformën, a ka familjar të punësuar Shemsi Haziri, në komuna, në Ministrinë të Shëndetësisë a kanë marrë specializime familjar të tij, a është punësuar dikush në Mitrovicë?

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë s Kosovës, Gazmend Hoxha**, nuk kam qenë mbikëqyrës i drejtpërdrejtë dhe nuk i kam këto informacione.

**Mefail Bajqinovci**, kur i bëni reformat, ai i trajtoni historiatin e persionit në fjalë?

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë s Kosovës, Gazmend Hoxha**, theksoi se sigurisht që trajtohen të gjitha informacionet, bazuar në trajnimet e tyre behën edhe lëvizja.

**Mefail Bajqinovci**, gjenerata e 54 e Policisë së Kosovës, a i plotëson kriteret për gradim, për gradën rreshter që janë në proces tani, pasi që ende nuk i ka mbushur dy vite, siç është përcaktuar në udhëzim.

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë s Kosovës, Gazmend Hoxha**, gjenerata e 54, është gjenerata e vetme, për të cilët trajnimi i tyre në Akademinë Policore, në vend se të zgjat 3 muaj, u ka zgjatur 9 muaj. Kjo gjeneratë e ka mbërritur kohëzgjatjen në polici prej pesë viteve me përvojë pune, si pasojë e kësaj, nuk ka qenë faji i tyre që nuk kanë mundur të arrijnë këtë përvojë. Menaxhmenti i policisë, me qëllim të trajtimit të barabartë të gjithsecilit, u kemi mundësuar edhe kësaj gjenerate që të aplikojnë për gradën e rreshterit. Qëllimi nuk është favorizimi i dikujt, por që mos të diskriminohen.

**Mefail Bajqinovci**, kur do të implementohet Drejtoria e Kryeqytetit?

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë s Kosovës, Gazmend Hoxha**, gjatë këtij viti kemi filluar me implementimin strukturës së re të policisë së Kryeqytetit, ku do të kemi një njësi unike të hetimeve për të gjithë kryeqytetin e Prishtinës, ku në kuadër të kësaj njësie do të jetë forenzika dhe njësi të hetimeve sipas veprave penale. Është krijuar sektori i trafikut, i hetimeve dhe njësia e mbështetjes operacionale për kryeqytet. Shpejt do të krijojmë edhe kapacitete të tjera me qëllim që ta bëjmë funksionale, strukturën e re të kryeqytetit.

**Mefail Bajqinovci**, tutje theksoi se ka rate për monedha të falsifikuara, ku për këto njoftohen krimet ekonomike, njësi e hetimit të parave të falsifikuara, por nuk i marrin këto raste për hetim shpesh, pasi ka mungesa në stacione?

**Agron Neza, Drejtor i Departamentit të Hetimeve**, theksoi se është evidente falsifikimi i parave viteve të fundit në Kosovë dhe rajon, me të gjitha rastet merren krimet ekonomike, gjithashtu përmes mediave kemi publikuar rezultate të prekshme kanë qenë, në këtë aspekt jemi konform procedurave standarde të operimit.



**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë s Kosovës, Gazmend Hoxha**, sa i përket kësaj, të gjitha rastet barten tek krimet ekonomike, mirëpo është e vështir që automatikisht në momentin që gjendet një para e falsifikuar adresohen, ndërsa voton paraprak dhe gjatë këtij viti, kemi pasur rezultate jashtëzakonisht të mira dhe jemi me një hetim ndërkombëtar me disa shtete, kemi konfiskuar diku tetëdhjetë e pesë mijë euro të falsifikuara, vizitë të shërbimit sekret amerikan, të cilët na kanë falënderuar.

**Mefail Bajqinovci**, sa i përket rastit të Albkings, ka qenë një shqetësim i madh për opinionin publik, për ngacmimin të miturave si dhe ndërtimin e stacionit policor në Kodrën e Trimave. Sa për informimin tuaj, numri i dillerëve në lagjen Kolovica dhe Kodrën e trimave është rritur shumë dhe ka nevojë për dërgimin e stacionit të policisë sa më shpejt. Ju lutem të përgjigjeni për këto pyetje?

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë s Kosovës, Gazmend Hoxha**, sa i përket rastit Albkings, janë duke u zhvilluar hetimet, ku Njësi për hetime ka bërë hetimin, janë bërë disa arrestime dhe është në zhvillime sipër. Ndërsa sa i përket stacionit policor në Kodrën e Trimave, theksoi se procesi është në OSHKP dhe pritet shpejt që të merret opinioni për këtë, qëllimi është që sa më shpejt të ndërtojmë atë objekt, pro nuk mund të tejkalojmë këto procedura.

**Agron Neza, Drejtor i Departamentit të Hetimeve**, sa i përket rastit Albkings Drejtoria për Hetimin e Krimeve Kibernetike, informacionet e para i ka filluar në vitin 2023, menjëherë është njoftuar Prokurori i shtetit, ku janë iniciuar hetime në tre vepra penale, vjedhje të identitetit, material me përmbajtje shfrytëzim dhe keqpërdorim seksual të fëmijëve, shantazhi. Deri më tani është arritur që të arrestohen katër persona dhe janë në vazhden e hetimeve dhe kanë bashkëpunim ndërkombëtar, sidomos me FBI. Ka sfida të ndryshme, pasi faqja është hapur prapë, pasi ka informacion që janë të hapura në Rusi dhe me vend ndodhje në Dubai, disa informacione nuk do të ndahen pasi jemi në fazën e hetimeve.

**Dimal Basha**, falënderoi për raportimin, ndërsa theksoi se është e rëndësishme që të theksohet roli mbikëqyrës i Komisionit, deri sa lidhet me ligjshmërinë e punës suaj, mirëpo ankesat e bëra këtu për strukturën organizative. Ne si deputet nuk mund të merremi me strukturën, që ti tregojmë Drejtorit ose Ministri se pse e kanë bërë këtë ndryshim, ose për vlerësimin e performancës, deputeti nuk duhet të hyjë në këtë detaj dhe është jo korrekte përmendja e emrave, shqetësimi kryesor është se si rrjedha e informacionit del nga policia dhe ju shkon deputetëve dhe pastaj merren me detajet e hetimeve. Kjo lënë të kuptohet se disa zyrtar policor, i shërbejnë grupeve të interesit. Tutje e konsideroi shqetësuese rastin e Albkings, pasi kanë ndërhyrë në privatësinë e qytetarëve, kërcënimin e gazetarëve, por besojmë që policia është duke u marrë me seriozitet. Tutje ftoi qytetarët e Kosovës që të lajmërojnë tek policia nëse kanë informacione për këtë grup, po ashtu çështja e kriptovalutave, si skema piramidale, ku janë pasqyruar edhe në media, ku qytetarët mashtrohen pasi u thuhet që mund të fitojnë me këtë investime. A është duke u hetuar në këtë fushë? Pasi Ligji për trafikun rrugor ka hyrë në fuqi, a mund të bëni një përmbledhje nëse keni pasur probleme në zbatimin e këtij ligji dhe sa ka arritur të zbatohet deri tani?

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë s Kosovës, Gazmend Hoxha**, sa i përket rasteve për kriptovalutat, thekso se nuk kanë pasur rast konkret, por ka dëgjuar nga kolegët nga Ferizaj që kanë dëgjuar nga qytetarët dhe si informacion do të trajtohet nga Njësi i krimeve kibernetike. Ndërsa sa i përket Ligjit të Trafikut, theksoi se është duke u zbatuar dhe ka rezultate, kemi mbi 30 përqind të rënies së trafikut, si me dëme, lëndime apo fatale dhe shpresojmë që edhe gjatë verës të kemi një rezultat të mirë.

**Agron Neza, Drejtor i Departamentit të Hetimeve**, sa i përket rasteve me kriptovalutat, theksoi se kanë informacione por në këtë takim nuk ka raport për këtë çështje, ndërsa kërkoi nga deputetët që të iniciojnë hartimin e ligjit për këtë fushë, pasi është fushë e re.

**Dimal Basha**, çfarëdo që e vlerësoni ne mund të bëjmë, skemat piramidale janë prezent gati në gjithë Kosovë, por duhet të merret seriozisht pasi ka edhe biznese që bëjnë manipulim, Andaj u bëjë thirrje qytetarëve që mos të bien pre, pasi ata krijojnë sisteme që i mashtrojnë qytetarët. Po ashtu i bëjë thirrje policisë që të angazhohen në këtë fushë.

**Kryetari**, dëshiroj të kthehem në temën për të cilën është ftuar Drejtori. Desha të kthehem tek vlerësimi i hetuesve, mos rastësisht notohen më pak ata zyrtar që kanë filluar hetimin për pushtetin.

**Agron Neza, Drejtor i Departamentit të Hetimeve**, ne e kemi një sistem të notimit, i cili bëhet nga mbikëqyrësi i parë dhe më pas kalo në nivelin e dytë, dhe si Drejtor nuk i shoh vlerësimet që bëhen dhe nuk lejohemi të shikojmë.

**Hisen Berisha**, falënderoi Drejtorin dhe ekipin e tij, ndërsa sa i përket raportimit, theksoi se ka shqetësime në opinion sa i përket strukturimit në polici, gjë e cila është diskutuar edhe në seancë. Shqetësimet e tilla nuk kanë mbet interne, tani shqetësime janë ngritur edhe në dy raporte ndërkombëtare të DASH dhe te Freedom House. Ndërsa si deputet ne informohemi nga qytetarë ose zyrtar, ndërsa ndryshim në strukturë bëhen për të penguar hetimet që kanë filluar, pastaj ka pretendime që keni pasur një përplasje me Prokurorinë Speciale, të cilët kanë kërkuar që këta polic hetues nuk mund të lëvizin përderisa janë në proces të hetimit, për tri tema të rëndësishme që janë afëra korruptive në diplomaci, energji, rezervat shtetërore. Këto çështje duhet të jenë shqetësuese, pasi çështja e strukturimit bëhet për përmbushjen e apetiteve të eprorëve të juaj, veprat e rëndomta etj., ne njoftohemi për gjithçka, por ne pajtohemi me qasjen e juaj profesionale. Shqetësuese janë temat e nivelit politik dhe që përmenden në raporte ndërkombëtare dhe që ndikojnë në imazhin e Kosovës. Ndërsa relativizmi për rastin e Shemsi Hazirit nuk është në rregull, pasi ai ka lënë gjurmë dhe kjo nuk duhet të lejohet.

**Kryetari**, a ka pasur tendencë për ty hetuar hetuesit, për zbulim të sekretit në rastin e rezervave shtetërore? Kush ka kërkuar hetimin e hetuesve që janë marrë me rastin e rezervave shtetërore?

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë s Kosovës, Gazmend Hoxha**, në përgjigjeje të pyetjeve të deputetin Berisha, theksoi se nuk janë viktimë e askujt dhe është përgjegjësi dhe krenari të udhëheq policinë dhe qëllimi është që të arrihen qëllimet organizatës dhe shtetërore. Nga kjo njësi nuk ka pasur asnjë lëvizje tjetër, përveç majorit Shemsi Haziri, asnjë lëvizje nuk bëhet me preferenca

politike dhe asnjë zyrtar nuk do të mbrohet sipas preferencave politike apo nga rajoni që vjen. Eprorët tanë janë asete dhe lëvizja bëhet me qëllim të shfrytëzimit të përvojës së tyre. Sa i përket kërkesë për hetim, është bërë nga Ministria, ankesa ka shkuar në Inspektoratin Policor të Kosovës, ndoshta për këtë do të duhej të pyesni Drejtorin e IPK-së.

**Hisen Berisha**, shqetësimi nuk është për zbatimin e procedurave të rregullta të tyre, por ky shqetësim është ngritur nga DASH-i, Freedom House e përmend me emër rasti i Shemsi Haziri, nëse nuk ka një raport për këtë çështje është shqetësuese. Po ashtu përmendi faktin që gratë me gradë kapiteni nuk janë zgjedhur në stacione, pavarësisht që i kanë plotësuar kushtet dhe në to janë emëruar burra, a ka pasur diskriminim?

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha**, theksoi se si polici janë duke e zbatuar agjendën gjinore dhe e kanë strategjinë dhe në gjeneratën e fundit policisë 20% kanë qenë femra dhe qëllimi është që të kenë më shumë femra në polici. Ndërsa sa i përket asaj për komandant stacioni, kriteri është që duhet të jetë me gradën kapiten ose major, nëse e keni fjalën për Podujevën, grada e atij pozicioni duhet të jetë major dhe ne u japim përparësi nëse ka femra dhe i plotësojnë kushtet. Sa për informim, Policia e Kosovës ka 14.7% gra të punësuar brenda institucionit dhe në krahasim me rajonin jemi më mirë në rajon.

**Fehmi Hoti, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës**, shtoi se z.Shemsi Haziri është dyshuar për çështjen e shpenzimit të karburanteve, është hetuar nga Standardet Profesionale por nuk janë gjetur shkelje, nuk mund të riaktivizojmë të themi çështje penale apo administrative pasi çështja ka marrë epilog.

**Erxhan Galushi**, ngriti çështjen e një raportimi në Drejtorinë Rajonale të Stacionit Policor në Pejë, ku në komunikimin e fundit që ka pasur, ka detajuar arrestimin e një burri ashkali për dyshimin se ka kryer një veprim të paligjshëm kundër një gruaje ashkali. Pavarësisht që reagimi ka qenë i shpejt, pra përmendja e etnitetetot nuk i shërben interesit publik, por përforcimi stereotipave në një komunitet që ende vazhdon të diskriminohet nuk i shërben askujt. Si institucione duhet të kërkojmë që të gjithë individët të trajtohen me respekt, sidomos nga institucioni që është i thirrur për ti mbrojtur të gjithë pa dallim. Rekomandoj që në të ardhmen raportet të jenë vetëm cilësimi si kosovar dhe pa e cekur komunitetin.

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha**, lidhur me formatin e raportimit, theksoi se ka qenë i tillë prej kohës së UNMIK-ut, duke dashur që të eliminohen problemet që mund të jenë në vazhdim, pro do të konsultohet Agjencia për informim dhe Privatësi dhe Zyra Ligjore e Policisë, në mënyrë që mos ët dëmtohet askush.

**Anton Quni**, nga Kryetari u bënë publike disa pretendime, që thuhet që një zyrtar i policisë që është marrë me një nivel korrupsioni në nivel të lartë, është transferuar në një pozitë tjetër. Përgjigjja nga Drejtori ishte që transferimi është bërë për shkak që në fushën tjetër do të kontribuoj edhe më shumë. Pat pretendime duke e stigmatizuar personalitetin e z.Shemsi Haziri, që nuk ka qenë i denjë dhe ka pasur shkelje, atëherë ai nuk do të ishte i denjë as në pozitën që është. Ndërsa nga z.Dimal Basha, u tha që nga ne nuk mund të diskutohet struktura organizative dhe të tjera. Sa i përket organogramit,

i përshtatet interesave të organizatës, pro nuk mund të ndodhë që dikush të transferohet në një pozitë inekzistene që nuk është paraparë në strukturë.

Të vërtetën ende nuk e dimë dhe është e drejta e jonë që ne mund të ftojmë z.Shemsi Haziri dhe të bisedojmë për këtë çështje, mund të ftojmë zëvendësin e tij aktual në Drejtorinë hetimeve, nëse ka shikëputje në hetime apo vazhdimësi. Mund të ftojmë edhe Prokurorin, për të dëshmuar nëse bashkëpunimi është i njëjtë si në kohën e z.Haziri. Nuk ka nevojë të rrisim tensione pasi neve na intereson si është e vërteta ndërsa ne e mbështesim Drejtorin në angazhimet e tij.

**Kryetari**, theksoi se pajtohet me kërkesat e Anton Quni, pasi shqetësimi është nëse ka vazhdimësi sa i përket hetimeve të nisura në kohën sa ka qenë z.Shemsi Haziri në hetime.

**Dimal Basha**, sa i përket raportit të DASH-it, sa i përket hetimi të ministrave dhe zëvendës ministrave, i citon mediat e Kosovës, pasi nëse e sheh referencën nuk është se Ambasada i nxjerr njerëzit në terren dhe kërkon hulumtim, por i citon mediat, pra këtë që ne e dimë. Pra jo që të gjithë ministrat hetohen. Sa i përket ligjshmërisë së punës, ne si Komisionit duhet të sigurohemi për këtë, ndërsa të thërrasim secilin zyrtar në Komision apo të ftohet prokurori, nuk është në rregull, pasi mund të konsiderohet edhe si ndërhyrje nga ana e tyre.

**Mefail Bajqinovci**, theksoi se sapa e njoftuan që Grupi AlbKings kanë kërcënuar gazetaren Ardiana Thaqi, kisha pasur dëshirë që policia të merret intenzivisht me këtë rast. Sa i përket zyrtarëve të teknologjisë informative, nëpër regjione, ka dallime në mes të pagës për pozita të njëjta. A keni diskutuar për rregullimin e kësaj fushë?

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë s Kosovës, Gazmend Hoxha**, sa i përket kërcënimit të gazetares Ardiana Thaqi, theksoi se personalisht ka komunikuar me të është raportuar rasti në polici dhe shumë shpejt do të ketë zhvillime. Sa i përket IT-së, kanë propozuar në Komisionin qeveritar që janë staf deficitar, fatkeqësisht këta që janë në nivel rajonal, nuk janë futur në këtë kategori, prapë e kemi dërguar në Komisionin Qeveritar, presim përgjigjeje finale.

**Shqipe Mehmeti Selimi**, për ti shërbyer transparencës maksimale dhe pyetjeve të ngritura, kërkoj që të ngritet një Komision Hetimor që të jemi transparent edhe me strukturën e policisë, gradimet, transferimet dhe kjo do ti shuante kureshtjen e pyetjeve dhe do ti shërbente transparencës. Sa gjatë shkon një raport për një çështje hetimore penale? Nuske e di a ka dalë raporti për rastin e rënies së qatisë në Komunën e Prishtinës dhe a e ka marrë çështjen Prokuroria?

**Agron Neza, Drejtor i Departamentit të Hetimeve**, rastet dallojnë nga njëri tjetri, ndërsa sa i përket qatisë së Komunës së re në Prishtinës, theksoi se është kompetencë e Drejtorisë rajonale të Prishtinës, që nuk është në Departamentin e Hetimeve.

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë s Kosovës, Gazmend Hoxha**, theksoi se nuk ka informacion të saktë por do ta sigurojmë dhe do të ju njoftojmë, në detaje do të ju njoftojmë pas pranimit nga Drejtoria Rajonale në Prishtinë.

**Shqipe Mehemti Selimi**, pra nuk keni njohuri nëse raporti ka përfunduar apo është mbyllur si hetim?

**Drejtori i Përgjithshëm i Policisë s Kosovës, Gazmend Hoxha**, theksoi se pasi të shkoj në zyrë do të kërkoj informacion dhe do të njoftoj. Ndërsa sa i përket kohëzgjatjes, theksoi se varte nga natyra e veprës penale.

**Enver Dugolli**, i nderuar Drejtor dhe bashkëpunëtor, është e mjaftueshme që shqetësimi i ngritur ka marrë epilog dhe ka sqarime nga Drejtori dhe bashkëpunëtorët. Përmendet shumë raporti i DASH-it dhe *Freedom Hous*, por e rëndësishme është ajo se çfarë dëgjuam këtu dhe janë statistikat që na bëjnë të besojmë punë e një njësie dhe krahasimi që u bë këtu, është mjaftueshëm për të tregtuar punë që është bërë. Në 2023 kemi shumë më shumë raste dhe hetime që ka bërë kjo njësi dhe rezulton që ka një rritje, pro si Komision nuk mund të ulemi në nivele që të thërrasim zyrtar policor në raportim, por Kuvendi e ka mundësinë të krijoj Komision Hetimor dhe ka forma dhe metoda, ndërsa është kundër për të thirrur në raportim zyrtar të niveleve më të ulte.

**Anton Quni**, theksoi se nëse politika i ka kapur këto institucione, atëherë është temë e diskutimit në Komision. Ne jemi ata që duhet të garantojmë që këto institucione janë të mbikëqyrura nga institucionet që janë të zgjedhura nga qytetarët. Nëse pretendimet e janë të sakta atëherë është e kundërta dhe për të vërtetuar këtë është Shemi Haziri dhe ata që kanë punuar me të, nëse ne frikësohemi nga e vërteta është çështje tjetër, prone e kemi këtë të drejtë, pra që të ftojme në raportim zyrtar të caktuar.

**Arbër Rexhaj**, theksoi se është e drejtë e opozitës të ngrejë dyshime, në fillim të raportimit u përmendet katër emra, ndërsa u tha që tre nga ta me vet dëshirë kanë kërkuar transferim, ndërsa kjo e tregon të gjithë situatën. Ndërsa letra e lexuar nga Kryetari, ishte narracion i marrë nga portalet dhe mediat e ndryshme, pra nëse ka kërkesë individuale të policëve që të ndërrojnë pozicionin, është vullnet i tyre. Çështja mbetet tek një emër, por do të doja që të thërrisim Ministrin e Punëve të Brendshme, te flasim me të. Policia e Kosovës ka qenë e shëndetshme që nga themelimi dhe mburremi me të, kërkoj që përball betejave ta ruajmë policinë.

**Kryetari**, Ministri është ftuar, po ashtu edhe Kryeshefi i IPK-së, për këtë çështje. Policinë e ruajmë duke e mbrojtur nga ndikimet politike. Unë e paraqita një pesë nga mediat por edhe versionin zyrtar të personave që e njohin mirë këtë fushë, dhe kjo çfarë lexova është e vërtetë, pasi ka tendencë të kapet policia në mënyrë që të pengohet hetimi për personat që kanë marrë miliona.

**Hisen Berisha**, sa i përket raportit të DASH-it, theksoi se ky raport kalon në disa filtra para se të publikohet dhe mbështet në fakte, pro është mirë të lihet anash propaganda, të paktën për këtë raport. Kërkoj që të lihen anash ndikimet politike, por ju Drejtor jeni i pavarur dhe vendosni në mënyrë të pavarur dhe do të duhej që ato çka kanë dalë në raport të merren seriozisht, sidomos në fushën e hetimeve, pasi raporti është serioz.

**Kryetari**, nëse nuk keni çështje të tjera, i falënderojmë Drejtorin me bashkëpunëtor për raportimin dhe i lirojmë nga takimi. Tutje njoftoi që me datë 31 maj ose 1 qershor Komisionerja e Forcave të

Armatura të Gjermanisë, znj.Eva Hogel, do të jetë në Kosovë dhe gjatë kësaj vizite është planifikuar një punëtori, ku të ftuar do të jenë Kryetari dhe tre anëtar. Luteni të konfirmoni kushdo që ka interes të marrin pjesë.

Nëse nuk keni çështje të tjera e mbyllim takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i Komisionit.**

**Bekë Berisha,**  
**Kryetar i Komisionit**

---

